


RAPORTI PRELIMINAR

I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT
TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT
PËR BARAZI GJINORE TË
KOMUNËS SË LIPJANIT



Autore:

Gresa Berisha

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë e shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Organizatës për Integrim dhe Zhvillim Social – Follow Up.

"Ky aktivitet I Organizatës për Integrim dhe Zhvillim Social – Follow Up, mbështetet nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, përmes projektit "Monitorimi dhe llogaridhënia me ndjeshmëri gjinore".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Organizatës për Integrim dhe Zhvillim Social – Follow Up dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.

RRETH FOLLOW UP

Organizata për Integrim dhe Zhvillim Social – Follow Up është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e cila synon të kontribuojë në fuqizimin e grupeve të marginalizuara dhe të promovojë barazinë gjinore, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin social në Kosovë.

Korrik 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Raporti Preliminar i Monitorimit të Zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për Komunën e Lipjanit është dokument monitorues i përgatitur nga Organizata për Integrim dhe Zhvillim Social – Follow Up në kuadër të programit të saj për barazi gjinore dhe fuqizim të komuniteteve. Qëllimi i këtij raporti është monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të objektivave dhe masave të përcaktuara në Planin Komunal të Veprimit për Barazi Gjinore të Komunës së Lipjanit.

Ky dokument ofron një vështrim kritik mbi përparimet, sfidat dhe mësimet e nxjerra gjatë periudhës së monitorimit, dhe ka për synim të kontribuojë në përmirësimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe rritjen e transparencës në zbatimin e politikave për barazi gjinore në nivel lokal.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
2. Metodologjia.....	7
2.1 Qëllimi dhe korniza metodologjike.....	7
2.2 Burimet e të dhënave dhe mjetet e mbledhjes	7
2.3 Analiza e të dhënave	8
2.4 Konsideratat etike dhe sfidat	9
3. Gjetjet.....	10
3.1 Fuqizimi ekonomik dhe të drejtat pronësore	10
3.2 Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	11
3.3 Arsimi, kultura dhe sporti	11
3.3 Prespektiva gjinore në politikat komunale dhe komunikim publik.....	12
3.4 Raportimi aktual dhe boshllëqet në të dhëna	13
3.5 Koordinimi i brendshëm.....	14
3.6 Mekanizmi i monitorimit.....	14
3.7 Potenciali i pashfrytëzuar i shoqërisë civile lokale	15
3.8 Të tjera	15
4. Rekomandimet.....	17
ANEKSET	20
Aneksi A: Lista e të intervistuarëve	20
Aneks B: Lista e pyetjeve për intervistë	20
Aneksi C: Matrica e treguesëve të PLVBGJ-së.....	22

Hyrje

Komuna e Lipjanit miratoi Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore (PLVBGJ) 2024-2026 në prill 2024, duke u pozicionuar ndër komunat e para në Kosovë që e harmonizojnë plotësisht legjislacionin vendor, gjegjësisht Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Programin Kombëtar për Barazi Gjinore 2020-2024, me standardet ndërkombëtare, si CEDAW, Objektivin 5 të Agjendës 2030 dhe Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Në kuadër të projektit Gender Equality Facility (GEF), të financuar nga Bashkimi Evropian dhe të zbatuar nga UN Women Kosovë, u parapa edhe një vlerësim i ndërmjetëm (mid-term review), në mënyrë që komunat të marrin sinjalet e para për progresin dhe boshllëqet, shumë përpara fazës përfundimtare të raportimit. Organizata vendore "Follow-Up", e kontraktuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, angazhoi ekspert për monitorimin dhe vlerësimin e këtij Plani.

Ky vlerësim mbulon periudhën prill 2024 – mars 2025 dhe synon të përgjigjet në tri pyetje kryesore:

1. Sa ka avancuar Lipjani drejt objektivave të PLVBGJ-së pas vitit të parë të zbatimit?
2. Cilat janë boshllëqet dhe pengesat kryesore që po e ngadalësojnë ose shtrembërojnë zbatimin?
3. Çfarë masash korrigjuese mund të ndërmerren tani, në mënyrë që në fund të vitit 2026 komuna të demonstrojë rezultate të matshme dhe të përputhshme me kërkesat e GEF-it dhe kornizave kombëtare?

Raporti është konceptuar si mjet praktik menaxherial: ai nuk synon të prodhojë një studim akademik, por t'u ofrojë vendimmarrësve lokalë, gjegjësisht, Kryetarit, drejtorive sektoriale, Kuvendit Komunal dhe vetë Komitetit Komunal për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, një pasqyrë të qartë dhe të verifikueshme të gjendjes faktike, bashkë me rekomandime të zbatueshme. Në këtë kuptim, hyn në lojë edhe dimensionin i llogaridhënies ndaj qytetarëve: PLVBGJ-ja, krahas buxhetit komunal dhe planit zhvillimor, është një prej dokumenteve me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e grave, vajzave dhe grupeve të tjera të marginalizuara. Publikimi i gjetjeve dhe rekomandimeve është pra pjesë e detyrimit për transparencë, por edhe një instrument edukues për komunitetin vendor, i cili ka të drejtë të dijë se si shfrytëzohen taksat dhe fondet e donatorëve.

Vlerësimi ndjek një metodologji të metodave mikse transformativë (mixed-methods transformative), të ndërtuar mbi tri shtylla teorike: qasjen gjinore-transformuese të UN Women, kriteret OECD DAC dhe udhëzimet pjesëmarrëse të Spotlight Initiative. Kjo gjithmonë duke e përshtatur atë me realitetin operativ të një administrate lokale në Kosovë: burime njerëzore të kufizuara, cikël buxhetor vjetor dhe procese raportimi kryesisht manuale. Në kapitullin që vijon shpjegohet në detaje se si janë kombinuar intervistat, dokumentet zyrtare, matrica e monitorimit dhe vëzhgimi online për të trianguluar të dhënat dhe për të siguruar besueshmërinë e gjetjeve.

Struktura e raportit vazhdon si më poshtë: kapitulli 2 përshkruan metodologjinë; kapitulli 3 paraqet gjetjet tematike; dhe kapitulli 4 jep paketën e rekomandimeve të detajuara, të ndara sipas fushave të ndërhyrjes. Në fund, anekset ofrojnë listën e intervistuarve, pyetjet për intervistë, dhe matricën e treguesëve me të dhënat përkatëse. Kështu, raporti synon të jetë një “hartë rruge” e vogël, por e përdorshme, për udhëtimin e Lipjanit drejt barazisë gjinore reale, e jo vetëm formale.

2. Metodologjia

2.1 Qëllimi dhe korniza metodologjike

Ky vlerësim i ndërmjetëm (mid-term review) mbulon periudhën nga miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore (PLVBGJ) në Komunën e Lipjanit në prill 2024 deri në mars 2025 dhe ka për qëllim të tregojë se ku qëndron sot Komuna e Lipjanit në krahasim me pritjet e Planit, cilat pengesa kanë dalë rrugës dhe si mund të korrigjohet drejtimi për pjesën e mbetur të zbatimit, që të rezultoj në një performancë të mirë dhe impakt sa më të madh.

Qasja metodologjike u ngrit mbi tri shtylla teorike që i dhanë strukturë dhe sens gjithë procesit. E para, qasja gjinore–transformuese e përshkruar në UN Women Evaluation Handbook garanoi që çdo pyetje, tregues e analizë të hynte poshtë sipërfaqes së numrave dhe të shihte pabarazitë strukturore që i mbajnë gratë e vajzat larg shërbimeve, buxheteve apo vendimeve (unwomen.org). Shtylla e dytë ishin kriteret e ripërditësuara të OECD DAC (2019), të cilat na ndihmuan të ruajmë ekuilibrin ndërmjet relevancës, koherencës dhe ndikimit pa e zhytur raportin në teknikizma të tepërt (oecd.org). Së fundi, morëm frymëzim nga udhëzimet mbi monitorimin e pjesëmarrjes dhe të drejtave të njeriut të Spotlight Initiative, që theksojnë se vetë komuniteti duhet të jetë bashkë-prodhues i njohurisë dhe përfitues i drejtpërdrejtë i gjetjeve (spotlightinitiative.org). Këto tre shtylla dialogojnë natyrshëm me udhëzimet akademike mbi dizajnet e metodave mikse transformative (mixed-methods transformative) të detajuara nga Creswell & Plano Clark (2023)(sciencedirect.com).

Përzgjedhja e mostrës ka kombinuar kampionimin gjithëpërfshirës (të gjitha drejtoritë që kanë aktivitet në PLVBGJ) me kampionim të qëllimshëm për intervistat, duke u bazuar në rolin në grupin punues, ekspertizën tematike dhe disponueshmërinë. Praktika “këmbë-dorë” (snowball) u përdor për të identifikuar personin më të informuar kur disa individë rezultuan të paarrtshëm.

Megjithatë metodologjia nuk u konceptua për të prodhuar një eksperiment shkencor; ajo u ndërtua për të ecur krah hapave të përditshëm të administratës së Lipjanit.

2.2 Burimet e të dhënave dhe mjetet e mbledhjes

Hulumtimi filloi me një takim orientues në Zyrën për Barazi Gjinore, ku zyrtari përgjegjës që gjithashtu ishte një nga anëtarët e grupit punues për hartimin e këtij plani, shpjegoi kronologjinë e hartimit e të miratimit deri në zbatimin praktik në periudhat e fundit. Ai gjithashtu ndau raporte të punës, lista të pjesëmarrjes, programe të aktiviteteve si ai i “16 Ditë Aktivizëm”, si dhe statistika të ndryshme. Ky takim shërbeu si “busull” për të ndërtuar skemën e intervistave dhe për të planifikuar procesin e mbledhjes së të dhënave për matricën e treguesëve të planit.

Pas këtij orientimi, u kaluan disa ditë të plota në mjediset e komunës, duke vizituar zyrat e drejtorive që ishin përgjegjëse për aktivitetet e PLVBGJ-së. Sidoqoftë, realiteti i administratës nënkupton pushime të papritura, udhëtime pune ose thjesht mungesë të përkohshme në zyrë për shkak të angazhimeve jashtë saj. Takimet, edhe nëse ishin caktuar paraprakisht, shpesh u anuluan, prandaj zyrtarët u lajmëruan se procesi i grumbullimit të të dhënave do të bëhej në një interval më të gjatë të ditës së punës dhe për disa ditë në vijim, në mënyrë që të tregohesh

përshtatshmëri ndaj agjendës së tyre. Njëkohësisht, u siguruan numrat e telefonit dhe adresat elektronike për zgjidhje alternative.

Shpeshherë, një zyrtar na drejtonte te një koleg i tretë, i cili rezultonte të ishte mbajtësi i informacionit. Ky zinxhir kontakti në dukje i lodhshëm, në praktikë na udhëhoqi te njerëzit më adekuatë dhe kur komunikimi ballë për ballë nuk mund të realizohej për një arsye ose tjetër, kalohej në telefon ose në adresë elektronike. Për t'u dhënë kohë zyrtarëve të kontrollonin dosjet dhe që gjithashtu të mos ngurronin nëse shihnin një dokument të gjatë, matrica e monitorimit u zbërthye në dokumente që përmbanin veçmas aktivitetet e secilës drejtori, dhe iu dërgua atyre në formë elektronike. Një pjesë e tyre u kthyen me adresa elektronike. Pjesa tjetër u plotësua gjatë vizitave fizike në zyrë, që ofruan mjaftueshëm kohë që ata të mund të hapnin arkivin, të konsultoheshin me kolegët dhe të plotësohej tabela pa e ndjerë veten nën presion.

Përveç të dhënave dhe dokumenteve zyrtare nga drejtoritë, u intervistuan gjithsej tetë persona (shih Aneks A: Lista e të intervistuarëve): tre ishin pjesë e grupit punues origjinal dhe pjesë e drejtorive kyçe, dy ishin zyrtarë që nuk kishin marrë pjesë në hartimin e planit - për të provuar nëse perceptimi ndryshonte tek ata që nuk e njohnin planin nga afër, një intervistë u krye me zyrën e informimit për të kuptuar sa dhe si publikohet progresi, ndërsa dy të tjerat me përfaqësues të shoqërisë civile lokale që punojnë me komunitetin në mënyrë aktive. Kur agjenda e të intervistuarve nuk lejonte takim fizik, kaluam në intervistë telefonike. Në disa raste u regjistruan intervistat, e në raste të tjera dukej më e përshtatshme që intervistimi të rrjedhë i lirë pa mikrofon, për të mos "ngrirë" diskutimin. Pyetjet ishin gjysmë-strukturore (shih Anex B: Lista e pyetjeve për intervistë): secili mund të sillte shembuj konkretë, shifra, por edhe reflektime personale për dinamikën e bashkëpunimit. Të gjitha intervistimet janë përmbledhur, dhe jo transkriptuar, dhe më vonë kanë kaluar një proces të thjeshtë të kodimit tematik për të nxjerrë fjalët kyçe rreth progresit, sfidave dhe zgjidhjeve të sugjeruara - që mjaftuan për të ndërtuar pamjen e përgjithshme të vlerësimit.

Dokumentimi nuk u kufizua tek arkivi i zyrave: faqja zyrtare e komunës dhe llogaritë në rrjete sociale u skanuan për çdo lajm, vendim, njoftim ose raport të publikuar prej prillit 2024. Në këtë mënyrë, çdo deklaratë publike u mat për koherencë me atë që thoshin raportet e brendshme.

Data-seti final mbështetet, pra, në katër burime: dokumentet zyrtare dhe të dhënat e dorëzuara nga drejtoritë, komunikimin fizik, elektronik dhe telefonik me drejtoritë, përmbledhjet e intervistave dhe vëzhgimin tonë të faqes zyrtare e mediave sociale të komunës.

2.3 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u zhvillua në dy kahje që ecën paralelisht. Së pari, për intervistat u përdor një kodim i thjeshtë me tri etiketa - progres, sfida, mundësi, që shërbyen për të organizuar shpejt informacionin pa transkriptim të plotë. Së dyti, të dhënat e matricës u përpunuan në dokument të vetëm në formë statistikore dhe deskriptive, duke i krahasuar vlerat e raportuara me indikatorët e planit për çdo objektiv. Triangulimi erdhi natyrshëm: aty ku një aktivitet përfshinte dy ose më shumë drejtori nga të cilat u pranuan të dhëna, ose kur një shifër në matricë përputhej me lajmet dhe dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të komunës, e shënuam si provë të dyfishtë të

besueshmërisë. Në këtë mënyrë, disa nga gjetjet cilësore dhe ato sasiore u përforcuan reciprokisht.

2.4 Konsideratat etike dhe sfidat

Në secilin hap, standardet etike dhe mbrojtja e të dhënave u respektuan pa kompromis. Formularët e pëlqimit, ruajtja e materialeve në një dosje të mbrojtur të projektit dhe shpjegimi i qëllimit të vlerësimit shoqëronin çdo ndërveprim. Para se të fillonte procesi i grumbullimit të të dhënave dhe i intervistimit, u nënshkruan paraprakisht formularët e pëlqimit, në mënyrë që individët të ndiheshin të sigurt për mënyrën se pse dhe si do të përdorej informacioni.

Një sfidë tjetër e veçantë, krahas të tjerave të lartëpërmendura, ishte fakti se komuna në të njëjtën kohë po përballej me një proces tjetër monitorimi për të njejtin plan nga ana e donatorëve. Disa zyrtarë nuk i dallonin, prandaj shfaqnin hezitim duke menduar se tashmë e kanë përfunduar një proces të tillë. Për ta tejkaluar konfuzionin, u sqarua qartazi ndryshimi mes dy proceseve dhe mënyra si do të koordinohen rezultatet.

Në fund, kjo metodologji mbeti besnike ndaj nevojave të terrenit: praktike, fleksibile dhe e përthithshme për institucionin që po e vlerësonim. Ajo iu përshtat ritmit real të administratës dhe u fokusua të sjellë argumente të qarta e të dobishme për komoditetin dhe përgjegjësinë e vetë komunës së Lipjanit.

3. Gjetjet

3.1 Fuqizimi ekonomik dhe të drejtat pronësore

Lipjani mbetet një nga komunat me përqindjen më të lartë të pronave të regjistruara në emër të përbashkët ose vetëm të grave. Më saktësisht, me 425 prona të regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve dhe 199 prona vetëm në emër të grave. Arritja lidhet me zbatimin e masave afirmative sipas udhëzimeve të kryeministrit, sesione informuese për të drejtat pronësore në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe duke përfshirë edhe komunitetet pakicë, si dhe priorizim të kriterit të pronës së përbashkët apo në emër të grave në skemat e subvencioneve. Brenda vitit të parë të zbatimit komuna ka shpërndarë 95 subvencione bujqësore për gra, duke kaluar kështu synimin prej 10% të të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, që mbështeten me subvencione në fushën e bujqësisë në 16%. Ndërsa në partneritet me dy organizata joqeveritare, janë shtuar edhe 53 grante shtesë për gratë në këtë sektor. Ky kombinim konfirmon se bashkëpunimi me shoqërinë civile mund të zgjerojë shpejt mbulimin e objektivave dhe impaktit të këtij plani.

Përveç Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyllëtarisë (DBP), asnjë drejtori tjetër nuk ruan të dhëna të ndara sipas gjinisë, vlerës financiare apo lokacionit. Vetë DBP arriti këto shifra vetëm pas një përlogaritjeje retroaktive dhe manuale, duke treguar se mungesa e sistemeve digjitale rrit kostot administrative. Për më tepër, kjo ishte e vetmja drejtori që kishte përcaktuar vlerën bazë. Përderisa treguesi kryesor është përmbushur dhe madje tejkaluar, zinxhiri i aktiviteteve (trajnime për pajisje, sesione informuese, sensibilizim për shërbime këshilluese, mbështetje për biznes-plane) që duhet ta bënte progresin të qëndrueshëm praktikisht nuk ekziston në të dhëna. Pa këto hallka, rrezikohet që rritja 16% të mbetet episod dhe jo prire. Tutje, një panair unik i produkteve të grave fermere u organizua në korrik 2024, por nuk ka shifra për ekspozueset apo mbështetjen financiare, ndaj indikatorët për promovimin e grave në treg mbeten bosh.

Drejtorja e Ekonomisë dhe Zhvillimit (DEZH) raporton një rigjallërim të skemave të saj pas nënshkrimit të dy marrëveshjeve bashkëpunimi me “Women for Women” dhe “Islamic Relief”, përmes të cilave u siguruan 24 grante për biznese në pronësi të grave. Në vitin 2024 nuk ishin raportuar mbështetje të tilla. Mirëpo, edhe të dhënat e dorëzuara për vitin 2025 nuk tregojnë një ndarje të qartë në mes të granteve për biznese dhe ato për start-ups. Pavarësisht se Komuna e Lipjanit i përgjigjet kërkesave të bizneseve dhe i ndihmon ato me të dhënat që ka, aktivitetet e këtij plani për bashkëpunime me korporata biznesesh për sigurimin e vendeve të punës dhe mundësive për punë praktike, për të rejt/rinjte dhe gratë nuk është arritur. E njëjta qëndron dhe për trajnimet e përfituesve/përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit.

Intervistat me OJQ-të lokale tregojnë se ato janë ndër aktorët më aktivë në fushat që mbulon DBP dhe DEZH, por që komuna i ka shfrytëzuar vetëm pjesërisht. Një bashkëpunim më i gjerë me ta,

do të mund të ofronte rezultate më me ndikim për komunitat, sidomos në aktivitetet që kanë mbetur prapa planit të punës.

3.2 Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Në terma të infrastrukturës (mamografi, ekupe mobile) Lipjani demonstroi potencial konkret, por mungojnë mekanizma bazë të menaxhimit të të dhënave si format e listave, ndarja sipas gjinisë/etnisë, raportet mujore, vlerat bazë etj. Prandaj, shpeshherë rezultatet nuk mund të maten kundrejt objektivave të planit. Pa këto, edhe suksese të dukshme (p.sh. kthimi i mamografisë) mbeten të izoluara dhe nuk ushqejnë përmirësim sistematik. Pra, fotografia e përgjithshme mbetet e pabaraspeshuar ndërmjet shërbimeve reale dhe mënyrës si dokumentohen ato.

Ekipet mobile raportojnë 1569 vizita familjare gjatë vitit 2024, përfshirë 821 fëmijë 0-3 vjeç dhe 340 gra, plus 408 vizita shtesë te familjet e komuniteteve Rom, Ashkalinjë, dhe Egjiptian. Kjo mbulon vetëm rreth 39% të objektivit vjetor prej 4000 vizitash, ndërsa mungon çdo ndarje mujore që do të tregonte nëse ritmi po rritet apo ngadalësohet. Listat e pjesëmarrjes nuk janë dorëzuar, prandaj nuk mund të verifikohet, p.sh., nëse fshatrat më të thella po mbulohen vazhdimisht.

Falë një mamografi digjitale të re (si donacion) dhe trajnimit të ekipit të radiologjisë, QKMF-ja nisi sërish shërbimin në tetor 2024; brenda gjashtë muajsh u bënë 228 ekzaminime për gratë 40+. Kjo tregon se, kur pajisjet dhe kapacitetet janë në vend, kërkesa ekziston. Megjithatë, nuk mbahet evidencë mbi profilin etnik apo socio-ekonomik të përfituesve, gjë që e kufizon analizën e ndikimit.

Në matricë figurojnë “381 takime informuese”, por shënimet tregojnë se 381 është numri total i pjesëmarrësve (271 nëna + 110 baballarë) dhe jo i seancave. Pa një regjistër të qartë (data, tema, listat e nënshkruara), është e pamundur të dihet sa shpesh janë mbajtur klasat, në cilat QMF dhe me çfarë rezultatesh.

Për aktivitetet promovuese të ndryshme është deklaruar se nuk ka pasur sesione/takime apo materiale të përgatitura dhe të shpërndara. Në “Tetorin Rozë” janë organizuar tri aktivitete kundrejt synimit 15 në vit. Këto lënë një boshllëk të dukshëm për qasje në informacion bazë për shërbimet që komuna ofron apo të drejtat e tyre. Edhe për aktivitetet e mbajtura, si trajnimi i personelit shëndetësor, nuk ka të dhëna të plota për numrin e profilin gjinor për të kuptuar ndikimin dhe boshllëkun. Të gjitha shifrat raportohen si totale; mungon ndarja gjinore/etnike/mosha për thujtje të gjitha aktiviteteve. Për disa aktivitete të tjera, si vizitat për gratë 65+ me sëmundje kronike, nuk figuron asnjë shifër. Kjo tregon se shërbimi ose nuk po zbatohet, ose se thjesht nuk po raportohet - të dyja skenarët kërkojnë veprim urgjent.

3.3 Arsimi, kultura dhe sporti

Lipjani po investon në festivale, libra dhe grante sportive, por pa ndarje gjinore e pa vlera bazë, këta numra tregojnë volumin, por jo ndikimin. Pa forma të unifikuar raportimi, as komuniteti, as vendimmarrësit nuk mund ta dinë nëse këto resurse po e ngushtojnë hendekun gjinor apo thjesht

po mbajnë në këmbë aktivitetet ekzistuese. Në letër PLVBGJ-ja kërkon që shkollat, hapësirat kulturore dhe klubet sportive të kthehen në motorë të ndryshimit gjinor; në terren, punët kanë nisur, por rezultatet shpesh nuk mund të “ngjiten” te objektivat, sepse të dhënat mbeten të përgjithshme e pa ndarje gjinore.

Drejtorja e Arsimit ka realizuar pesë sesione orientimi profesional në total për vitin 2024-2025 për 125 nxënës, kur parashihet 3 për vit por të dhënat nuk janë të ndara në baza vjetore. Dhjetë ligjëratat kundër martesës së hershme dhe pesëmbëdhjetë aktivitetet mbi dhunën me bazë gjinore mbulojnë afërsisht 60% të volumit të parashikuar, ndërsa njëzet sesionet mbi trafikimin e qenieve njerëzore arrijnë vetëm një të tretën e objektivit total të kalendarit tre-vjeçar. Sidoqoftë, edhe pse është thënë se listat e pjesëmarrjes për këto aktivitete ekzistojnë, të njejtat nuk janë dorëzuar për verifikim të informacionit. Pa informacionin e saktë të ndarjes së pjesëmarrjes, vështirë të thuhet nëse ndërhyrjet po e zënë vërtet grupin e shënjestruar. Takimet e bashkë-organizuara nga Zyra e Komuniteteve dhe Drejtoria e Arsimit me familjet e nxënësve në rrezik braktisjeje kanë rezultuar pozitivisht, duke shmangur dy largime nga shkolla. Kjo është një dëshmi se aktivitetet e planit, kur zbatohen, prodhojnë efekt të drejtpërdrejtë.

Nga ana tjetër, aktivitetet për trajnimet dhe aftësimi i grave në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, janë planifikuar në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore. Në përgjithësi në tërë planin një numër i madh sesionesh informuese e trajnimesh të parapara kanë mbetur të parealizuara. Edhe pse gjatë grumbullimit të të dhënave nuk është dhënë ndonjë arsye specifike, nga intervistat është kuptuar se mund të jetë kryesisht për shkak të agjendave të ngarkuara dhe mungesës së stafit. Ky boshllëk hap mundësi që këto ngarkesa të delegohen te organizatat lokale joqeveritare, të cilat tashmë kanë eksperiencë dhe rrjete me komunitetin dhe potenciali i tyre nuk shfrytëzohet sa duhet, siç janë deklaruar vet përfaqësuesit e shoqërisë civile në intervistat e këtij vlerësimit.

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjithashtu ka shpërndarë mbi dyqind mijë euro midis 36 OJQ-ve rinore dhe klubeve sportive dhe ka mbajtur një sesion informuese me fokus vajzat, të rejat dhe gratë për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete sportive. Për këtë të fundit nuk janë dorëzuar të dhëna për pjesëmarrje për të vlerësuar nëse targetet janë arritur. Bibliotekat u pasuruan me rreth dy mijë libra të rinj, ndërkohë që plani synon të arrijë tre mijë deri në fund të 2026-ës. Por, inventari aktual nuk shënon autoret gra, ndaj objekti “rritja e përqindjes së titujve nga gratë” nuk mund të matet. Për festivalet dhe organizimet e tjera kulturore raportohet për përfshirjen e vajzave dhe grave, por nuk ka lista specifike që emërojnë ato. Pa këtë provë, dhe pa vlerat bazë që nuk janë përcaktuar nga drejtoria e linjës, nuk mund të vlerësohet rritja e pjesëmarrjes së vajzave në art. Tutje, në organizime të tilla me pjesëmarrje më të madhe, komuna nuk ka forma se si e llogarit numrin e pjesëmarrësve.

3.3 Prespektiva gjinore në politikat komunale dhe komunikim publik

Për herë të parë, tri dokumente zyrtare si Plani i Veprimit Komunal Për Strehim Familjar, Statusi i Qendrës për Punë Sociale, dhe Draft Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë kanë marrë komente të strukturuar për integrimin e perspektivës gjinore. Përmirësimi është i dukshëm, por procesi mbetet informal dhe varet nga nisma individuale e Zyrës për Barazi Gjinore; nuk përdoret

ende një “fletë kontrolli” standard. Po ashtu, publikimi i vegëzës së re për Barazi Gjimore në faqen e komunës nuk është përfunduar akoma dhe nuk përdoret ndonjë thurje (hashtag) tematik për të shenjuar aktivitetet pro barazisë në rrjetet sociale, duke humbur shansin që progresi të jetë i dukshëm për publikun.

3.4 Raportimi aktual dhe boshllëqet në të dhëna

Raportimi funksionon në formë zinxhiri: zyrtari i sektorit raporton te drejtori, që i mbledh të dhënat për të gjithë njësinë dhe pastaj i raporton te Zyrja e Kryetarit. Kjo e fundit e përmbyll procesin duke e raportuar si Raport i Punës te Kuvendi Komunal. Raportet, të cilat përfshijnë të gjitha punët, bashkohen çdo gjashtë muaj e publikohen si PDF të përgjithshme, pa seksion të veçantë për PLVBGJ-në. Pra, nuk ka procedurë apo formë standarde se si raportohet vetëm për këto aktivitete, informacioni është vështirë i qasshëm pasi nuk ka një bazë të unifikuar se ku ruhen të dhënat, dhe posedohet kryesisht vetëm nga ata që kanë qenë drejtpërdrejt të përfshirë. Gjithashtu, nuk dokumentohet secili aktivitet siç kërkohet. Edhe kur grumbullohen të dhëna, shembull për sa libra të rinj janë blerë për bibliotekën, ato merren vetëm si total. Mungojnë detajet që i japin kuptim planit, si numri i titujve nga autore gra apo përmbajtja me temë barazinë gjimore. Kështu, raporti paraqet shifra voluminoze, por nuk tregon nëse investimi po ndihmon vërtet gratë dhe vajzat që plani synon të fuqizojë. Kjo gjë e vështirëson monitorimin dhe vlerësimin e këtij plani, por dhe planifikimin e brendshëm të drejtorive për të arritur performancën e tyre të kënaqshme.

Mosraportimi i duhur është gjithashtu humbje e mundësisë për të gjeneruar përmbajtje informative si infografika dhe raporte të vecanta për progresin e punës në kuadër të PLVBGJ-së. Humbje e mosraportimit të duhur është edhe kur zyrtarët bëjnë një punë “të padukshme”: ata ndihmojnë fermerët të plotësojnë formularët e subvencioneve në Drejtorinë e Bujqësisë, ose artistët lokalë të hartojnë aplikime për grante në Drejtorinë e Kulturës. Mirëpo, sepse këto orë këshillimi jepen jashtë çdo procedure të formalizuar, kontributi u humbet në statistika. Ndërkohë ka shume sesione informuese e trajnime të planit që kanë mbetur pa u organizuar. Në dokumentet zyrtare del sikur asistencë teknike nuk ka ndodhur kurrë, edhe pse komuniteti përfitues dhe vetë stafi e dinë se koha dhe ekspertiza janë shpenzuar realisht. Mungesa e raportimit bën kështu punën e vlefshme të zyrtarëve të padukshme për planin dhe për mekanizmat e monitorimit.

Për më tepër, matrica e monitorimit nuk ishte parë nga asnjë zyrtarë deri në vizitën e vlerësimit. Gjithashtu, vlerat bazë mungojnë për të gjitha treguesit, me përjashtim të atij për subvencionet bujqësore; rrjedhimisht, vlerat vjetore nuk mund të llogariten. Kjo pavarësisht faktit që ka të dhëna nga të cilat mund të kalkulojnë. Një arsye pse këto kanë mbetur si të tilla mund të jetë edhe mospërcaktimi i drejtorisë përgjegjëse për treguesit përkatës, edhe pse përmbajtja e tyre mund të lidhet lehtësisht me drejtorinë relevante. Arsye të tjera mund të jenë mungesa e ekspertizës apo udhëzimeve se si duhet të bëhet kjo. Edhe kur aktivitetet raportohen se janë realizuar, ato shpesh nuk kapin objektivat numerikë të planit - thjesht sepse stafi punon pa e pasur përpara matricën me targetet përkatëse. Po të kishin qasje të menjëhershme në atë skedë, drejtoritë do të planifikonin më saktë volumen, kohën dhe burimet, ndërsa vetë matrica do t’u shërbente si “kujtesë” praktike për ato synime që tash për tash mbeten vetëm në letër.

Lista e pjesëmarrësve nuk ka një format standard. Ajo herë administrohet dhe ruhet nga OJQ-të, herë nga komuna, duke shënuar zakonisht vetëm me emër e mbiemër. Pothuajse gjithmonë mungojnë fushat për gjini, moshë, etni; ndonjëherë mungojnë edhe datat dhe titujt që e bën të kuptueshme vetëm për organizatorin, dhe atë në afate të shkurta. Të gjitha versionet ruhen në letër, shpesh në zyra të ndryshme duke e vështirësuar qasjen. Kjo ishte edhe arsyeja pse shumica e drejtorive nuk kanë dorëzuar lista si dëshmi. Tutje, aktivitete të rëndësishme të volumit më të madh, si panairët ose ngjarjet kulturore, komuna ka vështirësi të përlogaris pjesëmarrjen e gjerë duke rezultuar thuhet në asnjë shifër të verifikueshme për përfituesit.

3.5 Koordinimi i brendshëm

Gjatë vizitave nëpër drejtoritë komunale u bë e dukshme një fenomen thuhet refleksi: sapo përmendej PLVBGJ-ja, zyrtarët e parë të orientonin menjëherë te Zyra për Barazi Gjinore, sikur çdo pyetje për planin t'i përkiste vetëm asaj zyre. Vetëm punonjësit që kishin qenë pjesë e grupit punues - pra përfaqësuesit e caktuar nga secila drejtori gjatë hartimit, kishin njohuri të detajuara. Kolegët e tyre fillonin ta eksploronin listën e aktiviteteve vetëm pasi niste biseda në terren, edhe pse dokumenti është miratuar prej më shumë se një viti nga Kuvendi. Kjo tregon se përgjegjësia ka mbetur e paformalizuar dhe njohuria është përqendruar te një grusht individësh. Rezultati është një kulturë “jo imja”, ku puna që mund të kontribuojë realisht në objektivat e planit nuk lidhet drejtpërdrejt me të. Për të thyer këtë model, nevojitet një komunikim i brendshëm periodik, i thjeshtë dhe i strukturuar, që ta bëjë planin të kuptueshëm për të gjithë, pronësi të përbashkët dhe të shpërndajë qartë rolet dhe detyrat për secilin tregues. Ose të integrohet më mirë në planet e tjera të punës së drejtorive.

3.6 Mekanizmi i monitorimit

Trupi i monitorimit të zbatimit të PLVBGJ-së në Komunën e Lipjanit është Komiteti Komunal për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore (KKDNJBGJ): një organ i kryesuar nga Nënkryetari i Komunës (ose një anëtar i Kuvendit të mandatuar nga Kryetari), ku marrin pjesë drejtorët komunalë, Zyrtari/Ja për Barazi Gjinore (në rolin e sekretariatit teknik), përfaqësuesi/ja i Grupit të Grave të Kuvendit dhe dy anëtarë të shoqërisë civile. Komiteti duhet të mbledhet të paktën dy herë në vit, të shqyrtojë raportet tremujore që i dërgojnë drejtoritë, të verifikojë progresin për secilin tregues të planit dhe të propozojë masa korrigjuese; më pas të hartojë raportin vjetor që i dorëzohet Kryetarit dhe miratohet në Kuvend, duke siguruar kështu mekanizmin zyrtar të llogaridhënies për Planin e Barazisë Gjinore.

Trupi monitorues i ngritur me vendim të Kuvendit u mbledh një herë në fillim, tentoi të hartojë një draft-plan pune dhe u shua. Kryesisht sepse kryesuesja doli në pushim lehonie dhe arsye të tjera të paspecifikuara që dërguan në jofunksionim. Kjo tregon edhe më shumë nevojën që informatat dhe aktivitetet të mos varen nga individët, por një organizim dhe përgjegjësi më kolektive. Pa këtë mekanizëm, raportimi kthehet në punë individuale të ZBGJ-së, pa verifikim ndërdrejtoror.

Edhe pse Zyrtari për Barazi Gjinore mban rolin e sekretariatit të Komitetit Mbikëqyrës, aktualisht nuk ekziston një bazë e unifikuar ku të mbledhen dhe të raportohen të gjitha të dhënat e PLVBGJ-

së. Çdo drejtori ruan informacionin me mënyrën e vet - shpesh në dosje fizike, dhe qasja tek këto dokumente varet nga prania e zyrtari që i ka përgatitur. Kjo i komplikon monitorimet periodike, e sidomos transferimin e njohurive kur stafi largohet, shkon në pushim ose pensionohet. Mekanizmi do të funksiononte shumë më mirë po të krijohesh një sistem i përbashkët (formularë standardë + databazë elektronike), ku të gjitha drejtoritë të ngarkonin raportet e tyre mujore; kështu, çdo anëtar i komitetit do të kishte qasje të menjëhershme në informacion dhe do të mund të ndjekë progresin e treguesve në kohë reale.

3.7 Potenciali i pashfrytëzuar i shoqërisë civile lokale

Organizatave lokale treguan se kanë ofruar zyrtarisht të marrin përsipër aktivitete të caktuara, si sesionet informuese që komuna nuk po arrin t'i mbajë (për grante biznesi, subvencione bujqësore, plane biznesi etj.), por nuk kanë marrë kurrë një përgjigje formale. Ndërkohë, vetëm njëra nga organizatat me programet e tyre kanë përfshirë rreth 100 përfituese, gjegjësisht gra sipërmarrëse, fermerë, të reja dhe nga komunitetet pakicë. Kjo shifër do të mund të regjistrohej si rezultat i PLVBGJ-së, po të ekzistonte një mekanizëm i bashkëpunimit dhe shkëmbimi sistematik të të dhënave.

Vetë OJQ-të japin raporte të detajuara për donatorët ndërkombëtarë (me lista të standardizuara pjesëmarrjeje, të ndara sipas gjinisë, moshës e etnisë); këto praktika mund t'u shërbenin drejtorive komunale për të unifikuar listat, por askush nuk i ka kërkuar deri tani. Sipas tyre, plani është hartuar mirë, por zbatimi ngec pikërisht për mungesë kapacitetesh dhe stafi – boshllëk që ato mund ta mbushin, nëse komuna i informon në kohë për aktivitetet dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi që formalizojnë kontributin e tyre dhe lejojnë raportimin e përbashkët të rezultateve.

3.8 Të tjera

Në Drejtorinë e Bujqësisë vërehet një numër shumë i ulët kërkesash nga gratë për subvencione që lidhen me pajisje të rënda. Stafi e shpjegon këtë me dy faktorë: mungesën e interesimit real (për shkak të kostos së lartë të mirëmbajtjes) dhe pezullimin e shërbimit këshillimor të Ministrisë së Bujqësisë, i cili më parë udhëzonte fermeret për aplikim.

Edhe kur aktivitetet e planit janë raportuar që nuk janë mbajtur, arsyeja shpesh nuk është definuar duke u thënë se nuk ka ndonjë arsye specifike.

Megjithëse Lipjani merr pjesë në disa projekte të mbështetura nga organizatat kombëtare e ndërkombëtare ku përfshihen edhe komuna të tjera, nuk ka asnjë marrëveshje bashkëpunim teknik të drejtpërdrejtë me një komunë tjetër brenda Kosovës ose në rajon. Zyrtarët pranojnë se kanë shkëmbyer përvoja “me raste”, por potenciali për projekte të përbashkëta—sidomos në fusha si fuqizimi i grave dhe rinisë—mbetet i pashfrytëzuar.

Aktivitetet për rritjen e pjesëmarrjes së grave në Këshillat Lokale nuk janë iniciuar ende. Duke qenë se cikli i ri i rizgjedhjes së këshillave nis në vjeshten të vitit 2025, mungesa e një kalendarit të qartë rrezikon që nismat sensibilizuese të mbahen shumë vonë për të ndikuar mbi përbërjen e mandateve të ardhshme.

Një ndikim i heshtur vjen edhe nga mbyllja e financimit të USAID-it, ashtu siç thekson Nënkryetari i Komunës gjatë intervistës, sidomos në fushën e të drejtave pronësore. Programet e mëparshme ofronin këshilla ligjore falas për regjistrimin e pronës në emër të grave si dhe shërbime të tjera të konsulencës. Pa këto shërbime, komuna ka mbetur pa një nga partnerin kryesor teknik për të avancuar këtë agjendë.

Në fund, ka një ndryshim gradual në perceptimin e barazisë gjinore nga një aktivitet që i takonte vetëm Zyrës për Barazi Gjinore në pjesë të punës të të gjitha drejtorive, por kjo mbetet në fazat e para. Pa një sistem të përbashkët të të dhënave dhe pa ndarje të qartë përgjegjësish, puna për barazinë gjinore mbetet e varur nga nisma individuale.

4. Rekomandimet

- **Krijimi i një databaze qendrore për PLVBGJ-në**
 - Të zhvillohet një databazë për të dhënat e PLVBGJ-së, sipas shembujve e praktikave më të mira nga komunat e tjera. Një mundësi mund të jetë që të gjitha drejtoritë ngarkojnë online formatin standard të raportit mujor dhe dokumentet ruhen në një hapësirë të përbashkët ku mund të qasen nga ZBGJ-ja, Kabineti i Kryetarit dhe Komiteti Monitorues.
 - Secila drejtori të ketë matricën e monitorimit dhe të planifikojë e të raportoj sipas saj.
 - Dokumentet të përfshijnë kolona të detyrueshme për gjininë, moshën, etninë, lokacionin dhe vlerën financiare, duke e zëvendësuar raportimin e fragmentuar në letra fizike.
 - Caktimi i vlerave bazë nga secila drejtori dhe verifikimi periodik nga Komiteti Monitorues.
- **Regjistër i unifikuar i granteve dhe subvencioneve**
 - Të dhënat të agregohen automatikisht në programet përkatëse si Excel, që të mënjanojnë gabimet teknike dhe duke i dhënë komunës shifra të sakta për raportim dhe analizë të hendekut gjinor.
 - Secila drejtori të ketë dokumentin e vet.
- **Fletë-kontroll për perspektivën gjinore (“Gender Check”) për të gjitha dokumentet komunale**
 - Të krijohet një fletë-kontroll për perspektivën gjinore.
 - Përpara se një rregullore, plan apo vendim të dërgohet në Kuvend, drejtoria plotëson një listë që verifikon gjuhën, alokimet buxhetore, ndikimin ndaj grave dhe burrave dhe treguesit raportohet.
 - Dokumentet pa këtë fletë nuk duhet të pranohen për shqyrtim, duke e shndërruar procesin në standard institucional.
- **Lista standarde e pjesëmarrjes për çdo aktivitet**
 - Të krijohet një formë standarde për pjesëmarrje në aktivitete, që do të ketë titullin e aktivitetit, datën dhe të gjitha të dhënat e tjera që kërkohen nga plani si gjinia, mosha, dhe etnia.
 - Edhe nëse aktiviteti organizohet me një partner tjetër të jashtëm (shembull OJQ), komuna duhet të ketë listën e vet ose të paktën të sigurojë një kopje të listës së partnerit dhe ta ruaj si duhet.
 - Listat rekomandohet të digjitalizohen dhe ngarkohen në databazën komunale, duke mundësuar verifikim të menjëhershëm nga Komiteti monitorues. Gjithmonë

duke pasur parasysh kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- **Formalizimi i kontributit të shoqërisë civile**

- Komuna duhet të zgjerojë bashkëpunimin me OJQ-të lokale, sidomos për aktivitetet që ka ngecje e që organizatat kanë kapacitet dhe ekspertizë. Shembull, për sesionet informuese apo trajnimet.
- Me anë të Memorandumeve për Bashkëpunim dhe bashkëpunimit apo facilitimit bazënga ana e Komunës, rezultatet e OJQ-ve do të mund të regjistroheshin si progres zyrtar i PLVBGJ-së, duke rritur shpejt mbulimin pa resurse njerëzore shtesë. Do të ishte një pasqyrim më i drejtë i asaj që arrihet në këtë fushë në Komunën e Lipjanit.
- Vendosja e një mekanizmi të strukturuar për shkëmbimin periodik të të dhënave brenda marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJQ-të.
- Bashkëpunimi i afërt me shoqërinë civile mund të rezultoj edhe në shkëmbimin e praktikave më të mira të dokumentimit dhe raportimit, që do të ngriste kapacitetet e komunës në këtë aspekt.

- **Rivitalizimi i Komitetit Komunal për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore**

- Komiteti duhet të ri-konstituohet me anëtarë zëvendësues për rastet e largimit ose lehonisë, duke siguruar kuorumin edhe kur stafi lëviz.
- Procesverbalet dhe rekomandimet publikohen në faqen komunale për transparencë dhe për të motivuar drejtoritë t'i zbatojnë.
- Plani i Punës së këtij trupi duhet të zhvillohet.
- Raportet e ndara të punës për PLVBGJ-në duhet të bëhen.

- **Integrimi i barazisë në raportin gjashtëmuor të punës dhe komunikimi**

- Në Raportin e pëgjithshëm të Punës mund të ndahet në një seksion të veçantë "Zbatimi i PLVBGJ-së", ku përfshihen infografika të thjeshta (progress-bar, grafika, harta).
- Kjo e bën progresin të dukshëm për Kuvendin, mediat dhe qytetarët, duke krijuar presion pozitiv për rezultate.
- Të publikohet vegëza për Barazi Gjinore në faqen e komunës dhe të plotësohet me informatat respektive për aktivitetet dhe raportet e PLVBGJ-së.
- Të krijohet njëthurje (hashtag) dhe plan komunikimi për të promovuar progresin dhe aktivitetet e komunës drejt barazisë gjinore.
- Nga të dhënat e raportit të PLVBGJ-së mund të krijohen dhe shpërndahen informacione të thejshtëzuara për të njoftuar qytetarë dhe palët e interesuara, siç janë infografikat.

- **Inventar gjinor në Bibliotekat e Qytetit**

- Në blerjet apo donacionet e ardhshme për bibliotekat, duhet të bëhet katalogimi dhe numrimi i titujve nga gratë.
- **Raportimi asistencës teknike**
 - Orët e ndihmës për aplikime, plane biznesi apo dosje kulturore regjistrohen në raportin mujor të drejtorive.
 - Këto orë pastaj mund të raportohen si arritje në raportin e PLVBGJ-së, duke bërë të dukshme përpjekjet e zyrtarëve.
- **Kalendar i detajuar për sensibilizimin e grave në Këshillat Lokale**
 - Duhet të publikohet një plan veprimi me datat e trajnimeve dhe fushatave, të sinkronizuara me procesin zgjedhor të këshillave.
- **Shfrytëzimi i rrjeteve ndër-komunale**
 - Lipjani mund të nis diskutimet për binjakëzim tematik me një komunë të suksesshme në barazi gjinore.
 - Shkëmbimi i praktikave dokumentohet dhe raportohet si aktivitet i PLVBGJ-së, duke shtuar dimensionin “koherencë horizontale”.

Me zbatimin e këtyre pikave, Komuna e Lipjanit kalon nga raporte voluminoze, por të fragmentuara, në një ekosistem të dhënash të unifikuara, transparencë publike dhe bashkë-përgjegjësi të qartë mes drejtorive dhe shoqërisë civile - bazë solide për ta mbyllur ciklin 2024-2026 me prova të prekshme ndikimi.

ANEKSET

Aneksi A: Lista e të intervistuarve

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni
1	Hasan Luma	Zyrtar për Barazi Gjinore, Komuna e Lipjanit; Anëtar i Grupit Punues për PLVBGJ
2	Diamant Bytyqi	Nënkryetar i Komunës së Lipjanit; Kryesues i Grupit Punues për PLVBGJ
3	Pranvera Krasniqi	Zyrtare në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport; Anëtare e Grupit Punues për PLVBGJ
4	Mirjeta Sllamniku	Konsulente për në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltarisë
5	Valon Ismajli	Konsulent në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltarisë
6	Ferdian Shala	Zyra e Informimit, Komuna e Lipjanit
7	Bekim Krasniqi	OJQ YAHR
8	Valmira Marevci	OJQ Qendra e Rinisë – Lipjan

Aneks B: Lista e pyetjeve për intervistë

PYETJE PËR ZYRTARËT KOMUNALË

1. A mund të përshkruani shkurtimisht rolin tuaj në zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore?
2. Cilat janë prioritetet kryesore për barazinë gjinore të përcaktuara nga komuna juaj?
3. Cilat veprime të PLBGJ-së janë zbatuar deri më tani?
4. A mund të ndani shembuj të aktiviteteve të përfunduara ose në zhvillim?
5. Si monitorohen dhe vlerësohen rezultatet e këtyre aktiviteteve?
6. Si bashkëpunoni me drejtoritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e planit?
7. Si e përfshini shoqërinë civile, veçanërisht gratë dhe të rejt/rinjtë, në planifikim dhe zbatim?
8. A ekzistojnë mekanizma për marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga qytetaret/qytetarët?
9. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballeni në zbatimin e PLVBGJ-së?
10. Çfarë lloj mbështetjeje (trajnime, financime, asistencë teknike) do t'ju ndihmonte më shumë?
11. Cili ka qenë suksesi më i madh deri më tani?
12. Cilat janë prioritetet tuaja të ardhshme në fushën e barazisë gjinore?
13. A ka ndonjë shembull suksesi që mund të ndajmë në raport për inspirim të komunave të tjera?

14. Cilat janë procedurat për mbledhjen dhe ndarjen e të dhënave gjinore – a janë të institucionalizuara?
15. Si është bërë koordinimi me OJQ-të për zbatimin e aktiviteteve në matricë?
16. A ka ndonjë komponent të PLVBGJ-së që ka qenë veçanërisht i vështirë për zbatim, dhe pse?
17. A ka pasur ndonjë reagim pozitiv nga komuniteti ose përfitueset në lidhje me aktivitetet e ndërmarra?
18. Cilat janë planifikimet konkrete për vitin 2025 në lidhje me veprimet e pazbatuara?

PYETJE PËR OJQ-TË LOKALE (bashkëpunëtorë të jashtëm)

1. Si e vlerësoni bashkëpunimin tuaj me komunën në zbatimin e PLVBGJ-së?
2. A jeni ftuar ose angazhuar gjatë fazës së hartimit të këtij plani?
3. Në cilat aktivitete të PLVBGJ-së keni marrë pjesë konkretisht?
4. A i konsideroni aktivitetet e zbatuara të rëndësishme për komunitetin lokal?
5. Cilat janë sfidat që i shihni në zbatimin e këtij plani?
6. A do të kishit rekomandime për mënyrën se si komuna mund të përmirësojë bashkëpunimin me shoqërinë civile?
A keni ndihmuar në përfshirjen e grupeve të marginalizuara në aktivitete?
7. Si është reflektuar zëri i grave dhe të rinjve në këtë proces?

Aneksi C: Matrica e treguesve të PLVBGJ-së

FORMATIN E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE MUND TA GJENI PËRMES [LINKUT](#) APO BARKODIT MË POSHTË:



